



A.nr.148/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, më Merlinda Ramaj në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.148/2026, të datës 06.02.2026, të parashtruar nga ankuesja M.D, nga Prishtina, më objekt ankese “*Ndërprerje e marrëdhënies se punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datë 13.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.148/2026, e datës 06.02.2026, e parashtruar nga ankuesja M.D.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 02/1-218-2026 i datës 05.02.2026, i Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Ankuesja M.D (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 06.02.2026, ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit më numër 02/1-218-2026 të datës 05.02.2026, të Divizionit për Burime Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, akt më të cilin ankuesit i është ndërpre marrëdhënia e punës, për shkak të mos konfirmimit të periudhës provuese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa, kjo e fundit, ka dorëzuar përgjigjen në ankese së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankесën me numër protokolli 680 i datës 06.02.2026 me numër A.nr.148/2026; Vlerësimin e Periudhës Provuese i datës 04.02.2026; Vendimi me numër 02/1-218-2026 i datës 05.02.2026, për ndërprerje të marrëdhënies se punës për shkak të mos konfirmimit të periudhës provuese; ID e ankueses; Vendimin për shtyrje të afatit

të trajtimit të lëndës së pranuar me datë 11.12.2025 për nëpunësen M.D; Kontratën e punës për periudhë të caktuar kohore; Emailin nga z. L.K i datës 20.09.2025; Emaili i M.D i datës 20.09.2026; Lista e orarit të punës; Komunikime elektronike; Deklarata e R.K., F.I., B.B.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje** tek Komisioni Disiplinor i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, **sepse**:

I. Gjendja faktike e çështjes

Nga provat materiale rrjedhë:

-Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 31.10.2024, ka shpallë Konkursin me numër reference RN00018531, për 15 pozitat e punës “Zyrtar i Shërbimit për Votues”, me kohëzgjatje të emërimit me afat të caktuar, për realizimin e një projekti, ku afati për aplikim ka qenë nga 27.08.2025 deri më 29.08.2025.

- Në këtë konkurs kishte aplikuar ankuesja, e cila sipas Njoftimit për rezultatet përfundimtare të datës 02.09.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve, është shpallur njëra ndër 18 kandidatët fitues.

- Organi përkatës i punësimit me datë 05.09.2025 ka lidhur Kontratën Nr.369/2025 të punës në periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht me kohëzgjatje nga data 08.09.2025 deri më 31.10.2025, me mundësi vazhdimi pas vlerësimit të nevojave të institucionit, më së shumti 3 vite.

-U.d. Udhëheqësi i Divizionit për Shërbim të Votuesve, përmes e-mailit të datës 20.09.2025, ka kërkuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, shkëputjen e kontratës për ankuesen, për shkak të vonesave në orarin e punës, mungesa gatishmërie për të kryer detyra të caktuara, të cilat janë pjesë e përshkrimit të detyrave të punës, mosrespektim i udhëzimeve të dhëna, duke rezultuar në kryerjen e detyrave në mënyrë të pasaktë dhe të përsëritur, si dhe për sjellje jo profesionale dhe mungesë respekti ndaj mbikëqyrësit dhe kolegëve, që cenon atmosferën e punës dhe bashkëpunimin në ekip.

-Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në KQZ bazuar në nenin 8 të Kontratës së punës me Nr.396 të datës 05.09.2025, pas shqyrtimit të kërkesës së lartë theksuar dhe pas takimit intervistues me Zyrtarët e Shërbimit Votues, në po të njëjtën ditë, përkatësisht me datë 20.09.2025, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 0211-2458-2025, për shkëputjen e njëanshme të kontratës së punës me Nr.369/2025, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Kontratës së punës.

-Ankuesja, kundër Vendimit me numër protokolli 0211-2458-2025, të datës 20.09.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, ky i fundit më Vendimin A.nr.1738/2025, të datës 24.11.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses, ka shfuqizuar vendimin e kontestuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek u.d. Udhëheqësi i Divizionit për Shërbim të Votueseve si mbikëqyrës i drejtpërdrejt, me arsyetimin se pretendimet e mbikëqyrësit ishin cilësuar si shkelje disiplinore dhe rasti duhet të trajtohet në këtë drejtim.

-Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, ka paraqitur rastin e ankueses në Komisionin Disiplinor të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, Komisioni Disiplinor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më datë 29.01.2026, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 145-2026, me të cilin rastin e ka kthyer tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për të nxjerrë akt administrativ për vlerësimin e periudhës provuese.

-Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, më datë 04.02.2026, ka bërë vlerësimin e periudhës provuese për ankuesen, duke arsyetuar se e njëjta ka treguar mungesë bashkëpunimi, nuk ka realizuar punët siç është kërkuar dhe nuk ka respektuar orarin e punës, duke mos e konfirmuar periudhën provuese, andaj si rezultat i kësaj U.D Divizioni për Burime Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 05.02.2026, ka nxjerr Vendim me numër 02/1-218-2026, për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të mos konfirmimit të periudhës provuese.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendim me numër 02/1-218-2026, të datës 05.02.2026, më pretendimin së periudha provuese është kaluar dhe e njëjta ka qenë me sukses, kështu që, meqë procedura ka kaluar në Komisionin Disiplinor atëherë konsiderohet që janë punëtore e rregullt. Gjatë punës sime nuk kam marr asnjëherë vlerësim negativ apo vërejtje, kështu që, kërkon që të aprovohet ankesa, anulohet vendimi i kontestuar me ankesë, obligohet institucioni të kthej në vendin e punës dhe të bëjë kompensimin e pagave të papaguara deri në kthimin në punë.

III. Vlerësim i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore iu referua bazës ligjore në fuqi, me thek të veçantë:

I. Rregullores (KQZ) NR.02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ

- Neni 1, i cili përcakton se: *Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil me kontratë për një periudhë të caktuar në KQZ.*

- Neni 2, i cili përcakton se: *1. Kjo Rregullore zbatohet nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) dhe Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), dhe përcakton procedurat për pranimin e personelit të përkohshëm: 1.1. Ndhmës, administrativ, teknik dhe mbështetës; 1.2. profesional.*

- Neni 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, ku përcaktohet se: *1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim: 1.1. Personel i përkohshëm, nënkupton personelin në nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj Rregullore, që rekrutohet për realizimin e projekteve të caktuara apo për plotësimin e një pozite, në rast të mungesës së përkohshme në KQZ.*

-Neni 4, ku përcaktohet se: *Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 1.1. Për realizimin e projektit të caktuar në KQZ; 1.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 2. Kontrata e punës për periudhë të caktuar lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nënparagrafit 1.1 të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nënparagrafit 1.2. të këtij neni. 3. I punësuari me kontratë sipas këtij neni, nuk gëzon të drejtën për vazhdim të kontratës së përkohshme, që tejkalon afatin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni*

.- Neni 26, ku përcaktohet se: *1. NJMBNJ, pas kryerjes të verifikimit, lidh kontratën me kandidatin në pozitën në të cilën ka aplikuar respektivisht në pozitën e përzgjedhur nga ai. 2. Pas nënshkrimit të*

kontratës, kandidati fitues duhet të paraqitet në KQZ, jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e nënshkrimit. Ky afat mund të zgjatet me kërkesë të kandidatit, për shkaqe të arsyeshme dhe me pajtimin e KQZ deri në dhjetë (10) ditë, duke përfshirë afatin fillestar. 3. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit të emëruar, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, NJMBNJ ndërpret kontratën. 4. Kontrata nënshkruhet nga NJMBNJ dhe kandidati sipas legjislacionit përkatës të punës. 5. **Kontrata e punës, për punësimin e personelit të përkohshëm për realizimin e projektit të caktuar të KQZ, sipas paragrafit 3.1 të nenit 37 të LZP, lidhet për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite.** 6. Kontrata e punës, për punësimin e personelit të përkohshëm për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme në KQZ, sipas paragrafit 3.2 të nenit 37 të LZP, lidhet për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se dy (2) vite. 7. **Personeli i përkohshëm i punësuar me kontratë sipas paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil në KQZ, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit.**

-Neni 28 Periudha provuese 1. Personeli i përkohshëm i cili punësohet për herë të parë, i nënshtrohet një periudhe pune provuese, që zgjatë sa 1/5 e kohëzgjatjes së kontratës. 2. Për periudhën provuese të personelit të përkohshëm zbatohen përshtatshmërisht rregullat për periudhën provuese të përcaktuara në Rregulloren Nr.01/2024 për pranimin e nëpunësve civilë në KQZ.

II. Rregullore NR. 01/2024 Për Pranimin e Nëpunësve Civil në KQZ

-Neni 37 Vlerësimi gjatë periudhës së provuese 1. Nëpunësi civil, gjatë periudhës provuese, i nënshtrohet vlerësimit të posaçëm të rezultateve në punë. 2. Kriteret që përcaktojnë vlerësimin e punës së tij/saj provuese, janë: 2.1. Realizimi i kënaqshëm i detyrave të punës; 2.2. gatishmëria, kreativiteti dhe vetëiniciativa për kryerjen e detyrave të punës; 2.3. respektimi i rregullave të mirësjelljes në shërbimin civil; 2.4. respektimi i orarit të punës. 3. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vlerëson nëpunësin civil gjatë tërë punës provuese dhe e informon për të arriturat dhe ngecjet në kryerjen e detyrave të punës.

-Neni 39 Konfirmimi ose mos konfirmimi i periudhës provuese 1. Në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos konfirmimin ose moskonfirmimin e vazhdimit të marrëdhënies së punës të nëpunësit civil. 2. Vendimi për konfirmimin apo moskonfirmimin, bazohet në vlerësimin e rezultateve në punë gjatë periudhës provuese.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji pas analizimit të provave materiale të çështjes ankimore, vlerëson së nuk gjejnë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të ankueses, sepse, vazhdimi i periudhës së punës së ankueses sipas kontratës të datës 05.09.2025, mund të bëhej vetëm nën kushtin nëse ankuesja i është nënshtruar procesit të vlerësimit fillimisht të periudhës provuese dhe vlerësimit të rezultateve para përfundimit të afatit të kontratës, ndërsa, në rastin konkret si pasojë e rrethanave faktike dhe juridike që kanë pasuar pas shkëputjes së njëanshme të kontratës së ankueses më datë 20.09.2025, rrjedhimisht pas procedurës ankimore dhe procedurës së rishqyrtimit të çështjes pranë organit publik punëdhënës, procesi i periudhës provuese të ankueses arrihet të përfundohet vetëm më datë 04.02.2026, ashtu që, sipas vlerësimi të mbikëqyrësit të ankueses ankuesja gjatë periudhës 08-20 shtator 2025 nuk ka përmbush kriteret e vlerësimit të periudhës punës, vlerësim ky që bazohej në arsyetimin se: *nëpunësja nuk ka respektuar udhëzimet në kryerjen e detyrave të punës, edhe pse i ishte shpjeguar në mënyrë të qartë si duhet të veproj*

dhe është trajnuar disa herë, ka treguar mungesë gatishmërie për kryerjen e detyrave të punës, ka treguar sjellje jo profesionale ndaj mbikëqyrësit dhe kolegeve si dhe ka pas vonesa në orarin e punës duke mos lajmëruar paraprakisht vonesat.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së me datë 20.09.2025, L.K në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime të Votuese, për shkak të vërejtjeve që kishte në raport me punën e ankueses për periudhën 08-19.09.2026, kishte kërkuar shkëputje të kontratës, po ashtu sipas deklaratave të datës 20.09.2025 të zyrtareve B.B, F.I dhe R.K del së të njëjtin kanë pohuar së ankuesja kishte vonesa në punë të cilat kanë ndikuar në realizmin e detyrave me kohë të punës, e njëjta ka tregu gabime në përmbushje të detyrave të saj të punës dhe se nuk kishte sjellje të mira kolegjiale.

Mbi bazën e konstatimeve si më lartë, gjegjësisht, pas vlerësimit së vendimi i kontestuar është nxjerrë në pajtim më ligjin material dhe mbi gjendjen e fakteve të vërtetuar drejtë, Kolegji në kuptim të nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.148/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, M.D;
- KQZ: Drejtorit Ekzekutiv dhe Divizionit për Burime Njerëzore dhe Administrim të Dokumenteve
- Arkivit të KPMSHCK-së.